



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2230/3 Prot

Rrëshen, më 29 . 05 . 2026

V E N D I M

Nr. 41 datë 26. 05. 2026

PËR

**“MIRATIMIN E MANUALIT UDHËZUES PËR PËRDORIMIN DHE MIRËMBAJTJEN
E OBJEKTEVE ARSIMORE NË BASHKINË MIRDITË”.**

Në mbështetje të nenit 54, pika 1, shkronja “e” dhe nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligji nr. 69/2012, “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Bashkisë Mirditë dhe Programit EU4Schools me nr. 4646, datë 13.11.2020, Manuali Udhëzues për Përdorimin dhe Mirëmbajtjen e Objekteve Arsimore (nr. 2230 prot, datë 19.05.2026) dhe Relacioni nr. 2230/1 prot, datë 19.05.2026 së bashku me projekt-vendimin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, pas shqyrtimit dhe miratimit, në mbledhjen e datës 25.05.2026, të Komisionit të Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës, për t’ia kaluar në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, pas diskutimeve;

V E N D O S I:

1. Miratimin e Manualin Udhëzues për Përdorimin dhe Mirëmbajtjen e Objekteve Arsimore
2. Manuali Udhëzues për Përdorimin dhe Mirëmbajtjen e Objekteve Arsimore (me nr. 2230 prot, datë 19.05.2026) dhe Relacioni nr. 2230/1 prot, datë 19.05.2026, bashkëlidhur, pjesë përbërse e këtij vendimi
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë; (Agjencia e Arsimit, Sportit dhe Ndihmës Sociale)

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor, nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.

SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ



KRYETAR

Aleksandër PICA KU

ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI”, RRËSHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al